


Nr 3507/Prot
12




BASHKIA TROPOJË

B. Curr, me 1.8.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJË

PLAN VENDOR I VEPRIMI PËR BARAZINË GJINORE

Periudha: 2025 – 2027




Punoi:

Gjerovica Osmaj
Aurela Prozellomi (Nezaj)
Suela Vatoci
Drande Pepkolaj
Ilirjana Ismajlisufaj

Kryetari i Bashkisë
Rexhe Byberi
Në mungesë dhe me Urdher
Zv/Kryetare
Zyra-Istamaj






BASHKIA TROPOJE

Tabela e Përmbytjes

Hyrja	1
Falenderime	4
Kuadri Ligjor dhe Institucional	5
Analiza e situatës gjinore ne territorin e bashkisë	8
Demografia	9
Popullsia sipas Gjendjes Civile	11
Numri i banorëve sipas gjinisë dhe grupmoshës	12
Analfabetizmi	13
Niveli Arsimit	14
Statusi martesor	16
Statusi i nënës	18

Frekuentimi i çerdhes, kopsht	20
Numri i banorëve të ndarë sipas gjinisë me aftësi të kufizuar PAK, Verber	
Para-tetraplegjike	22
Numri i banorëve që trajtohen me Ndihme Ekonomike sipas kategorive	25
Numri I bizneseve dhe Fermerve	26
Mekanizmi I Referimit te Rasteve te Dhunës në Familje	28
Rastet e dhunës në famije 2023-2025	29
Treguesit e sygjeruar gjinor dhe social	31
Metidologjia	35
Vizioni dhe objektivat strategjike	36
Monitorimi dhe Raportimi	47
Format e Raportimit	48




HYRJE

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 - 2027 u përgatit nga Bashkia Tropojë, si mjet kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendorë .

Ky plan ka rëndësi themelore pasi shënon një standart të ri për qasjen institucionale ndaj barazisë gjinore në Tropojë, duke formalizuar për herë të parë këtë angazhim me një dokument të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Ky plan duhet të shërbejë si një mjet praktik për të koordinuar veprimet ndërsektoriale, për të fuqizuar mekanizmat vendorë si Komisionin për Barazinë Gjinore apo Mekanizmin e Koordinuar të Referimit, si dhe për të siguruar pjesëmarrje më të gjerë në vendimmarrje të grave, të reja dhe grupeve të tjera të cenushme, apo më shumë akses në shërbime. Plani synon të vendosë gjithashtu bazat për ndërlidhjen e politikave të barazisë gjinore me procesin e buxhetimit në nivel vendor dhe me instrumentet kombëtare të politikave për barazinë gjinore.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2027, i pari plan në këtë drejtim u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, Këshillin Vendor Rinor, anëtare e anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lira/lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Eomen, 2011).




REPUBLIKA E ALBANI
MINISTRI E ARIMIT DHE SPORTIT

Drejësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Eömen, 2011).¹

Sikurse përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe rriprodhimin e pabarazive, si dhe të përparojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve vendorë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave ,të reja dhe të rinjve , vajzave dhe djemve. Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes vendore.

PVVBGJ 2025 - 2027 është konceptuar dhe lidhur logjikisht me nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, me kuadrin ligjor dhe të politikave kombëtare, si dhe instrumentet kryesorë ndërkombëtarë të ratifikuar nga shteti shqiptar lidhur me barazinë gjinore. Fuqizimi i grave, të reja e vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore për Bashkinë Tropojë.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PVVBGJ 2025 - 2027, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit përkatës dhe dokumentet kryesorë ku mbështeten hapat e planifikuar. Pavarësisht ndërhyrjeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme, me gjithë përpjekjet e bëra apo që vijojnë të bëhen ndër vite për përparimin drejt barazisë gjinore, si dhe plotësimin e harmonizimit e kuadrin ligjor dhe të politikave vendore me ato kombëtare e ndërkombëtare, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë,




komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj. Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes vendore të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikat e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të reja dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin tonë ekonomik dhe shoqëror.

Asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të reja dhe të rinjve, vajzave e djemve, pra të të gjitha/gjithë anëtareve dhe anëtarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të reja dhe vajzave, mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore.


Bashkia mbetet e përkushtuar për të ndërtuar një shoqëri të drejtë, ku askush nuk mbetet pas dhe ku të drejtat e çdo individi respektohen e garantohen. Ne besojmë se për të arritur këtë vizion, është e nevojshme një përpjekje e përbashkët dhe një bashkëpunim i ngushtë me të gjithë aktorët e shoqërisë. Prandaj, ftojme të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat të bëhen pjesë aktive e zbatimit të këtij plani.

Angazhimi ynë, drejt një bashkie më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse!



Falenderime

Bashkia Tropoje shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025–2027. Falënderojmë në mënyrë të veçantë Këshillin Bashkiak Tropoje, i cili ka mbështetur këtë proces, duke siguruar një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse në hartimin e planit. Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive e sektorëve vendorë, organizatave të shoqërisë civile, grupeve komunitare dhe partnerëve lokalë që ndihmuan në pasqyrimin e nevojave të vërteta të komuniteti. Një falenderim të veçantë ka Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Mbrojtjes Sociale për përkushtimin që ka treguar në mbledhjen e të dhënave dhe hartimin e Planit në një kohë shumë të shkurtër .




II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUACIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Në nenin 18 të Kushtetutës qartësohet shprehimisht se: “1. *Të gjitha/gjithë janë të barabarta/barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive*”.


Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentesh ndërkombëtare, të cilët kur ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zënë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjislacionin vendas, atëherë për zgjidhjen e saj u drejtohem parashikimeve në instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 – 2027 përveçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

- a) *Instrumente ndërkombëtare*
- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore (EU Charter for Equality).²
 - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË).
 - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPPA).
 - Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
 - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Agjenda 2030.



- Strategjia e Barazisë Gjimore 2025-2027 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjimore -2025/2027.
- Udhërrëfyesi i BE-së për fuqizimin e grave, publikuar në 7 mars 2025³, etj.
- Strategjia e Barazisë Gjimore 2025-2027 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjimore -2025/2027.
- Udhërrëfyesi i BE-së për fuqizimin e grave, publikuar në 7 mars 2025⁴, etj.
- **b) *Kuadri ligjor kombëtar*⁵**
 - Ligji Nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjimore në shoqëri” (në proces rishikimi).
 - Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
 - Ligji Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
 - Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.
 - Ligji Nr.221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
 - Ligji Nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - Ligji Nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
 - Ligji Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”.
 - Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
 - Ligji Nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.
 - Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.



RASHIA TROPJUE


- Ligji Nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”.
- Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Ligji Nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i procedurës penale”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin”.
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”.
- Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimin”
- Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë”, i ndryshuar

b) Politikat kombëtare

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2025 - 2027 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët (drejtoritë) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030**.

c) Institucionet përgjegjëse

Siç përshkruhet edhe në Kartën Evropiane për Barazi, përgjegjës kryesorë për zbatimin e kësaj Karte përmes përgatitjes dhe zbatimit të PVVBGJ, janë bashkitë. Në mënyrën se si është ndërtuar dhe funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, në nivel të vetëqeverisjes vendore janë Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore (NBGJ) përgjegjëse/përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, të cilat/cilët përveçse brenda institucionit të tyre raportojnë, sipas kërkesës, edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. **Megjithatë, ky Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, nuk është plani i një nëpunëseje/nëpunësi të vetëm, por është një dokument i Bashkisë, për zbatimin me efektivitet të të cilit mban përgjegjësi i gjithë stafi i bashkisë dhe njësive administrative, në bashkëpunim dhe me të gjithë institucionet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në këtë drejtim.**



Analiza e situatës gjinore ne territorin e bashkisë


Bashkia Tropoje është pjesë përbërëse e Rajonit Verilindor zë pjesën lindore të Alpeve, gropën e Tropojës dhe . Në lindje kufizohet me Republikën e Kosovës, në perëndim me rrethin e Shkodrës ndërsa në veri kufizohet me Malin e Zi dhe në jug ndahet me Pukën e Kukësin. Rrethi I Tropojës është një rreth me terren malor.Lugina e Valbonës është një nga luginat, e cila në rrjedhën e mesme kalon në pellgun e Tropojës, një vend I sheshtë dhe i populluar e cila e bën Tropojën shumë të lakmueshme nga turistët e huaj edhe vendas .Bashkia karakterizohet nga një bashkëjetesë e harmonishme mes komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare, duke ruajtur traditat dhe identitetin unik të zonës.

Bashkia Tropoje përfshin 8 njësi administrative

Njësia Administrative	Tipologjia
Bajram Curri	urban
Tropoje (e vjeter)	rural
Fierzë	rural
Bujan	rural
Llugaj	rural
Lekbibaj	rural
Margegaj	rural
Bytyç	rural

Burimi i të dhënave: INSTAT

Sipas të dhënave të fundit, bashkia ka një popullsi rreth **14189 banorë**, me një shpërndarje të popullsisë si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.



BASHKIA E TROPOJËS

Në aspektin social, bashkia është përballur me sfida që lidhen me emigrimin dhe migrimin e të rinjëve, papunësinë, dhe nevojën për përmirësim të shërbimeve sociale, në veçanti për grupet më vulnerabël si gratë, të moshuarit, dhe personat me aftësi ndryshe.

Bashkia Tropoje është e angazhuar në përmirësimin e qeverisjes vendore dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke promovuar vlera si transparencë, barazia dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, hartimi i **Planit të Barazisë Gjinore** përfaqëson një hap të rëndësishëm në përpjekjet për të integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikatat dhe shërbimet publike të ofruara nga bashkia.

Demografia

Tabela më poshtë paraqet popullsinë e bashkisë sipas gjinisë:


Popullsia	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
Popullsia	7073	7116	14189	49.8%	49.2%

Burimi i të dhënave: *INSTAT*


Popullsia është e ndarë nëpër njësi administrative si më poshtë:

Nr	Njesia Administrative	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Bajram Curri	2026	2087	4113	49.2%	49.8%
2	Tropoje (e vjeter)	1286	1274	2560	50.2%	49.8%
3	Fierzë	589	560	1149	51%	49%
4	Bujan	864	874	1738	49.7%	49.3%
5	Llugaj	573	617	1190	48%	52%
6	Lekbibaj	349	295	644	54%	46%
7	Margëgaj	941	966	1907	49%	51%
8	Bytyç	445	443	888	50.1%	49.9%

Burimi i të dhënave: *INSTAT*




Popullsia sipas Njesive Administrative



Sipas të dhënave të fundit, bashkia ka një popullsi rreth **14189 banorë**, me një shpërndarje të popullsisë sipas njësive administrative :


- Njësia Administrative Bajram Curri përbëhet nga **28.9 %** të popullsisë .
- Njësia Administrative Tropoje e Vjeter përbëhet nga **18 %** e popullsisë .
- Njësia Administrative Fierzë përbëhet nga **8.5%** e popullsisë .
- Njësia Administrative Bujan përbëhet nga **12.2%** e popullsisë .
- Njësia Administrative Llugaj përbëhet nga **8.3%** e popullsisë .
- Njësia Administrative Lekbibaj përbëhet nga **4.5%** e popullsisë .
- Njësia Administrative Margegaj përbëhet nga **13.4%** e popullsisë .
- Njësia Administrative Bytyç përbëhet nga **6.2 %** e popullsis.



Popullsia Sipas Gjendjes Civile Bashkia Tropoje

Nr	Emertimi i Njesive	Total gjithsejt	Meshkuj	Femra
1	Njesia Administrative B.Curr	8076	4146	3930
2	Njesia Administrative Tropoje Fshat	5750	3001	2749
3	Njesia Administrative Margegaj	3248	1678	1570
4	Njesia Administrative Llugaj	2267	1150	1117
5	Njesia Administrative Fierze	2390	1225	1165
6	Njesia Administrative Bytyç	2159	1106	1053
7	Njesia Administrative Bujan	2874	1468	1406
8	Njesia Administrative Lekbibaj	1540	809	731
	Shuma total	28304	14583	13721

- Njesia Administrative B.Curr zene 28.5% te popullsisë
- Njesia Administrative Tropoje Fshat zene 20.3 % te popullsisë
- Njesia Administrative Margegaj zene 11.4% te popullsisë
- Njesia Administrative Llugaj zene 8 % te popullsisë
- Njesia Administrative Fierze zene 8.4 % te popullsisë
- Njesia Administrative Bytyç zene 7.6% te popullsisë
- Njesia Administrative Bujan zene 10.4 % te popullsisë
- Njesia Administrative Lekbibaj zene 5.4 % te popullsisë




INSTITUTI I TROPJËRË

Numri i banorëve sipas gjinisë dhe grupmoshës

Burimi i të dhënave: INSTAT

Njësia Administrative	Meshkuj				Femra			
	Totali	0-14 vjeç	15-64 vjeç	65+ vjeç	Totali	0-14 vjeç	15-64 vjeç	65+ vjeç
Bajram Curri	2026	352	1347	327	2087	319	1444	324
Tropojë e vjeter	1286	217	867	202	1274	220	818	236
Fierzë	589	100	381	108	560	92	352	116
Bujan	864	162	529	173	874	245	534	195
Llugaj	573	128	362	83	617	106	394	117
Lekbibaj	349	52	236	61	295	55	182	58
Margegaj	941	180	601	160	966	168	617	181
Bytyç	445	80	293	72	443	65	304	74





MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Ky tregues nënvizon domosdoshmërinë për ndërhyrje të posaçme që synojnë përfshirjen arsimore të meshkujve, përmes programeve të edukimit për të rritur dhe fushatave sensibilizuese në nivel komunitar.


Niveli Arsimit

Të dhënat tregojnë një shpërndarje të ndryshme gjinore në nivelet e ndryshme të arsimit, duke reflektuar tendenca sociale dhe sfida potenciale për barazinë gjinore në fushën e arsimit dhe më gjerë.

Tabela më poshtë paraqet nivelin arsimor të popullatës.

Gjinia dhe bashkia	Gjithsej Totali	Asnje arsimor I përfunduar	Arsim Fillor	Shkollë /9 vjeçare	Shkollë e ulët teknike	Shkollë mesme	Asim pas të mesmes, por jo I lartë	Arsim I lartë, shkurtuar	Bachelor	Master ose Doktoraturë	Nuk kanë ndjekur asnjëherë shkollën
Gjithsej Total	11748	49	573	3823	18	5154	99	151	890	708	283
Tropojë Meshkuj	5802	14	201	1650	11	3039	62	83	365	272	105
Femra	5946	35	372	2173	7	2115	37	68	525	436	178

Burimi i të dhënave: INSTAT



Të dhënat mbi nivelin arsimor të popullsisë në Bashkinë Tropojë tregojnë një shpërndarje gjinore që pasqyron dinamika të rëndësishme sociale dhe sfida të vazhdueshme në drejtim të barazisë në arsim. Kjo analizë është e vlefshme për të kuptuar më mirë sfidat dhe mundësitë për promovimin e barazisë gjinore në fushën e arsimit dhe më gjerë.


Asnjë nivel arsimor i përfunduar – Në këtë kategori përfshihen **49 persona, nga të cilët 71% janë gra dhe 29% mashkuj**. Gratë përbëjnë shumicën, duke treguar se ato kanë qenë më të prekura nga mungesa e aksesit në arsim, sidomos në të kaluarën apo në zonat më të thella, ku normat sociale dhe përgjegjësitë tradicionale kanë ndikuar në shkëputjen e tyre të hershme nga shkolla.

Arsimi fillor – Nga gjithsej **573 persona** me vetëm arsim fillor të përfunduar, **65% janë gra dhe 35% burra**. Kjo shpërndarje e ngjashme me kategorinë e mëparshme sugjeron se një pjesë e madhe e grave ka ndërprerë shkollimin në këtë nivel, çka mund të lidhet me faktorë si presionet familjare, mungesa e infrastrukturës shkollore në afërsi, dhe pa mundësitë ekonomike apo mungesa e mbështetjes për vijimin e mëtejshëm të shkollës.

Shkolla 9-vjeçare – Ky është një nga nivelet më të përhapura të arsimit, me gjithsej **3 823 persona**. Nga këta, **57% janë gra dhe 43% burra**. Kjo shpërndarje relativisht e balancuar tregon një përmirësim të aksesit në arsimin e detyrueshëm për të dyja gjinitë, veçanërisht në brezat e rinj.

Arsimi i mesëm – Nga **5 154 persona** që kanë përfunduar arsimin e mesëm, **59% janë burra dhe vetëm 41% gra**. Kjo tregon një rënie të ndjeshme të pjesëmarrjes së vajzave krahasuar me arsimin 9-vjeçar dhe përforcon faktin se vajzat ende përballen me barrierat për të vazhduar shkollimin pas ciklit të detyrueshëm.

Bachelor – Nga **890 persona** me diplomë Bachelor, **41% janë burra dhe 59% gra**. Kjo shpërndarje është pothuajse e barabartë, duke treguar se vajzat që arrijnë të ndjekin shkollën e mesme kanë gjasa të krahasueshme me djemtë për të vazhduar studimet e larta.



Master ose Doktoraturë – Nga 708 persona me këto nivele të larta arsimore, 52% janë gra dhe 38% burra. Gratë përfaqësojnë shumicën, duke reflektuar një rritje të ndjeshme të pjesëmarrjes së tyre në arsimin akademik të avancuar dhe një tendencë pozitive drejt barazisë në arsim të lartë.

Përmbledhje: Të dhënat tregojnë dy prijje të dallueshme: në nivelet më të ulëta të arsimit, gratë përfaqësojnë një pjesë më të madhe të atyre që nuk kanë përfunduar arsimin bazë; ndërsa në nivelet e larta, përfshirja e tyre është më e lartë dhe në disa raste më e madhe se ajo e burrave. Kjo sugjeron përmirësim në aksesin dhe vijueshmërinë e arsimit për gratë, por gjithashtu tregon se boshllëqet gjinore në arsim vazhdojnë të ekzistojnë në ciklin e ulët dhe të mesëm.

Për këtë arsye, është e rëndësishme që politikat vendore të përqendrohen në parandalimin e braktisjes shkollore të vajzave, nxitjen e përfshirjes së tyre në arsimin e mesëm dhe promovimin e vazhdimësisë drejt arsimit të lartë. Këto masa janë kyçe për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë.

Statusi martesor

Tabela me poshte paraqet popullsine mbi 10 vjec sipas statusit martesor

Nr	Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Beqar(e)	3175	2411	5586	56.8%	43.2%
2	I/e martuar	3720	3685	7405	50.2%	49.8%
3	I/e divorcuar ose i/e ndarë	64	69	133	48%	52%
4	I/e ve	114	951	1065	10.7	89.3%

Burimi i të dhënave: INSTAT



BASHKIA TROPOJE

Shpërndarja sipas statusit martesor në Bashkinë Tropoje tregon dallime të dukshme gjinore, që pasqyrojnë norma kulturore, jetëgjatësi dhe dinamika të ndryshme familjare mes burrave dhe grave.

Në kategorinë “beqar(e)”, ka gjithsej **5586 persona**, nga të cilët **56.8% janë burra** dhe **43.2% gra**. Burrat përbëjnë shumicën dërrmuese të të pamartuarve, çka mund të shpjegohet me prijen e tyre për t’u martuar më vonë krahasuar me gratë, ose me tendencën për të qëndruar më gjatë në këtë status për arsye ekonomike, personale apo kulturore.

Në kategorinë “i/e martuar”, nga **7405 persona**, **50.2% janë burra** dhe **49.8% gra**. Kjo shpërndarje është relativisht e balancuar, duke reflektuar përfshirjen e të dy gjinive në institucionin e martesës, megjithatë përqindja pak më e lartë e burrave mund të lidhet me faktorë si migracioni apo jetëgjatësia më e ulët e burrave, që ndikon në rënien e numrit të grave të martuara në moshë më të madhe.

Në kategorinë “i/e divorcuar ose i/e ndarë”, janë regjistruar **133 persona**, ku **48% janë burra** dhe **52% gra**. Ndryshe nga tendenca kombëtare ku gratë shpesh përbëjnë shumicën e të ndarëve, në Bashkinë Tropoje burrat rezultojnë më të shumtë në këtë kategori. Kjo mund të lidhet me normat kulturore mbi stigmatizimin e grave të ndara apo me faktin që burrat më shpesh formalizojnë ndarjen ligjore.

Në kategorinë “i/e ve”, ka gjithsej **1065 persona**, ku **89.3% janë gra** dhe vetëm **10.7% burra**. Ky dallim i fortë reflekton diferencën në jetëgjatësinë mes gjinive: gratë jetojnë mesatarisht më gjatë dhe rrallë rimartohen pas vdekjes së bashkëshortit. Kjo situatë krijon një grup të ndjeshëm shoqëror me nevoja specifike, që shpesh përballlet me vetminë, mungesën e përkrahjes dhe sfida ekonomike.

Përmbledhje: Të dhënat tregojnë se statusi martesor ndërthuret ngushtë me gjininë, duke krijuar situata të ndryshme për burrat dhe gratë në faza të ndryshme të jetës. Gratë janë veçanërisht të ekspozuara ndaj pasojave sociale dhe ekonomike të të qenit të veja ose të ndara, ndërsa burrat dominojnë në grupin e beqarëve dhe të ndarëve. Këto prije duhet të merren parasysh gjatë hartimit të politikave sociale dhe shërbimeve mbështetëse në nivel vendor, me qëllim fuqizimin dhe mbrojtjen e grupeve më të cënueshme.



BASHKIA TROPOJE

Statusi i nënës


Tabela më poshtë tregon numrin e grave që bëhen nëna sipas grupmoshës.

Grupmosha	Kane lindur	Nuk kanë lindur	Gjithsej	% kanë lindur	% NUK kanë lindur
15-24 vjeç	61	821	882	6.9	93.1
25-34 vjeç	412	259	671	61.4	38.6
35-44 vjeç	682	104	786	86.7	13.3
45-54 vjeç	977	104	1081	90	10
55-64 vjeç	1154	71	1225	94	6
65-74 vjeç	630	43	673	93.6	6.4
mbi 75 vjeç	605	23	628	96.3	3.7

Burimi i të dhënave: INSTAT

Të dhënat mbi lindshmërinë sipas grupmoshës në Bashkinë Tropoje tregojnë një shpërndarje të qartë ndërmjet brezave, ku gratë mbi 25 vjeç janë në shumicën dërrmuese nëna, ndërsa përçindja e grave pa fëmijë është dukshëm më e lartë tek grupmoshat më të reja. Ky ndryshim reflekton tendencat moderne, rolet sociale dhe vendimmarrjen individuale të grave në lidhje me riprodhimin.


- **Në grupmoshën 15–24 vjeç**, vetëm **6.9%** e vajzave dhe grave kanë lindur fëmijë, ndërsa **93.1%** nuk kanë lindur. Kjo është një shifër në përputhje me tendencat bashkëkohore, ku shtyhet mosha e parë e lindjes për shkak të përfshirjes më të madhe në arsim, ndjekjes së karrierës ose përzgjedhjes personale për të mos hyrë herët në rol prindëror.
- **Në grupmoshën 25–34 vjeç**, **61.4%** e grave kanë lindur dhe **38.6%** jo. Kjo grupmoshë përfaqëson fazën më aktive të jetës riprodhuese, megjithatë përçindja e grave pa fëmijë është ende e konsiderueshme, çka tregon se një pjesë e tyre e shtynjtinë lindjen për arsye të ndryshme personale apo sociale.
- **Në grupmoshën 35–44 vjeç**, **86.7%** e grave kanë lindur fëmijë, ndërsa vetëm **13.3%** nuk kanë lindur. Kjo tregon se pjesa më e madhe e grave në këtë grupmoshë tashmë e kanë përmbushur rolin prindëror në kuptimin tradicional.



- Në grupmoshat më të mëdha 45–54 vjeç (90%), 55–64 vjeç (94%), 65–74 vjeç (93.6%) dhe mbi 75 vjeç (96.3%) – lindshmëria arrin në nivele shumë të larta, duke pasqyruar normat sociale të brezave të mëparshëm, ku të qenit nënë ishte një pritshmëri kulturore dhe sociale pothuajse universale për gratë.

Përmbledhje – Kjo shpërndarje tregon një ndryshim të dukshëm ndërbrezor lidhur me normat sociale. Gratë e reja, sidomos ato nën 25 vjeç, në pjesën më të madhe nuk janë ende nëna, çka mund të interpretohet si pasojë e rritjes së pjesëmarrjes në arsim, përfshirjes në punësim dhe ndryshimeve në rolet gjinore. Ndërkohë, gratë në moshë më të madhe kanë ndjekur modele më tradicionale të jetës familjare dhe janë përfshirë gjerësisht në prindërim.

Ky informacion është i vlefshëm për të kuptuar nevojat sociale të grave në faza të ndryshme të jetës. Gratë e reja mund të kenë nevojë për mbështetje në planifikimin familjar, akses në informacion mbi shëndetin riprodhues dhe programe që lehtësojnë balancimin e karrierës me jetën personale. Ndërkohë, gratë që janë ose kanë qenë nëna mund të kenë nevojë për përkrahje në përkujdesjen për fëmijët, përfitime sociale dhe ndihmë në sfidat e mëvonshme të jetës familjare.




ISHMERI TROPËDIË


Frekuentimi i çerdhes, kopsht

Tabela më poshtë paraqet numrin e fëmijëve që ndjekin çerdhen dhe kopshtin

Gjenia dhe moshë	Tropojë			
	Gjithsej	Ndjekin çerdhen	Ndjekin kopshtim	Nuk ndjekin
Gjithsej	1023	157	279	587
Meshkuj	526	77	149	300
Femra	497	80	130	287

Burimi i të dhënave: INSTAT





BASHKIA TROPOJE

Nga gjithsej **1023 fëmijë** të moshës 0–6 vjeç në territorin e Bashkisë Tropoje, **157 fëmijë** (rreth **15.3%**) ndjekin çerdhen, ndërsa **279 fëmijë** (rreth **27.2%**) nuk ndjekin kopshtin, në total 587 fëmijëve nuk ndjekin as çerdhen dhe as kopshtin.

Ndër fëmijët që ndjekin çerdhen, **80 janë vajza dhe 77 djem**. Edhe pse diferenca nuk është e vogël, numrin më të lartë të vajzave tregon një prijje të lehtë drejt përfshirjes më të madhe të vajzave në çerdhe.


Ndër fëmijët që ndjekin Kopshtin, **130 janë vajza dhe 149 djem**. Edhe pse diferenca nuk është e madhe, numrin më të lartë të djemve tregon një prijje të lehtë drejt përfshirjes më të vogël të vajzave në Kopshte

Tek ata që **nuk ndjekin as çerdhena kopshtin, 287 janë vajza dhe 300 djem**, duke treguar gjithashtu një shpërndarje relativisht të barabartë gjinore, pa dallime të theksuara në aksesin ndaj këtij shërbimi.

Ajo që bie më shumë në sy është se **vetëm rreth 1 në 3 fëmijë** të kësaj grupmoshe ndjekin çerdhen, ndërsa pjesa më e madhe (**78.9%**) nuk përfitojnë nga ky shërbim. Kjo përquajtje e ulët mund të shpjegohet me mungesën e çerdhëve publike ose kapacitetet e kufizuara, koston për familjet, distancën gjeografike të institucioneve apo normat tradicionale që nxisin kujdesin në shtëpi, zakonisht nga nëna ose anëtarë të tjerë të familjes.

Kjo situatë ka ndikim të drejtpërdrejtë në barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale, pasi mungesa e aksesit në çerdhe kufizon aftësinë e prindërve kryesisht të grave – për të ndjekur punësimin, arsimin ose pjesëmarrjen në jetën publike. Gratë mbajnë shpesh barrën kryesore të kujdesit për fëmijët e vegjël, krahas përmbushjes së roleve tradicionale gjinore në familje, siç janë kujdesi për shtëpinë dhe për anëtarët e tjerë të familjes veçanërisht për të moshuarit. Në mungesë të mbështetjes institucionale, këto përgjegjësi ndikojnë ndjeshëm në kufizimin e mundësive të tyre për zhvillim personal dhe profesional.

Prandaj, kjo analizë nënvizon nevojën për zgjerim të shërbimeve të çerdhëve dhe për politika lokale që e bëjnë këtë shërbim më të aksesueshëm dhe të përballueshëm për të gjitha familjet – si një masë konkrete për të promovuar barazinë gjinore dhe mbështetjen e familjes në kujdesin ndaj fëmijëve.




Kështu, të dhënat e Bashkisë Tropoje zbulojnë një prije që mund të çojë në **vazhdimësinë e ciklit të pabarazisë gjinore**: fëmijët mbeten jashtë kopshtit → nënat mbajnë barrën e kujdesit → gratë kufizohen në punësim dhe zhvillim profesional → rritet varësia ekonomike dhe sociale.

Kjo tendencë duhet të merret në konsideratë në planin për barazinë gjinore të Bashkisë Tropoje, me ndërhyrje konkrete për të:

- **rritur përfshirjen e fëmijëve**, sidomos në zonat ku përçindja e pjesëmarrjes është e ulët,
- **zgjerruar dhe përmirësuar kapacitetet e kopshteve publike**,
- **ofruar lehtësira për prindërit punonjës**, si orare fleksibël dhe mbështetje financiare, dhe
- **promovuar ndarjen e drejtë të kujdesit brenda familjes**, duke sfiduar normat tradicionale që e ngarkojnë vetëm gruan.

Numri i banorve të ndare sipas gjinise me aftësi të kufizuara

	Njesia Administrative	Meshkuj PAK	Femra PAK	Rom PAK	Gjithsej PAK	Aftesi e kufizuar mendore	Aftesi e kufizuar fizike
1	Bajram Curri	73	87	4	160	88	72
2	Tropoje (e vjeter)	82	89	0	171	74	97
3	Fierzë	27	27	0	54	19	35
4	Bujan	39	45	0	84	46	38
5	Llugaj	27	25	0	52	22	30
6	Lekbibaj	18	14	0	32	17	15
7	Margegaj	37	41	0	71	41	37
8	Bytyç	15	15	0	30	12	18




RRSHIQA TROPOJE

Te Verbër

	Njesia Administrative	Meshkuj Verber	Femra Verber	Gjithsej Verber	Aftesi e kufizuar shqisore shikimi
1	Bajram Curri	7	7	14	14
2	Tropoje (e vjeter)	2	4	6	6
3	Fierzë	8	0	8	8
4	Bujan	1	2	3	3
5	Llugaj	3	0	3	3
6	Lekbibaj	0	2	2	2
7	Margegaj	4	1	5	5
8	Bytyç	3	3	6	6

Para-Tetraplegjike

	Njesia Administrative	Meshkuj Para-Tetraplegjike	Femra Para-Tetraplegjike	Gjithsej Para-Tetraplegjike	Aftesi e kufizuar fizike/mendore
1	Bajram Curri	7	7	14	14
2	Tropoje (e vjeter)	2	3	5	5
3	Fierzë	1	1	2	2
4	Bujan	3	0	3	3
5	Llugaj	2	2	4	4
6	Lekbibaj	0	1	1	1
7	Margegaj	3	5	8	8
8	Bytyç	1	2	3	3



Tabelat më sipër tregojnë personat me aftësi të kufizuara të cilët janë të ndarë sipas njësive dhe kategorive të diagnozave .

Në bashkinë Tropojë na rezultojnë se 4.5% e popullsisë janë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike ,PAK, nga të cilët 2.2 % janë meshkuj dhe 2.4% janë femra .

Me aftësi të kufizuara shqisore shikimi kemi 0.3% të popullsisë nga të cilët 0.1 % janë meshkuj dhe 0.2 % femra .

Me aftësi të kufizuara fizike/mendore Para-Tetraplegjikë janë 0.3 % e popullsisë nga të cilët 0.1 % janë meshkuj dhe 2% janë femra .

Të dhënat mbi personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Tropojë tregojnë një **prirje të qartë gjinore**, e cila duhet të merret në konsideratë në planifikimin e politikave sociale dhe të barazisë gjinore..

Kjo tregon se **gratë me aftësi të kufizuara përballen me sfida të shumëllojshme**, si kufizime fizike, vështirësi ekonomike, mungesë aksesesh në shërbime dhe pengesa kulturore. Ato shpesh përjetojnë një **formë të dyfishtë të diskriminimit** – si gra dhe si persona me aftësi të kufizuara – duke u përjashtuar nga pjesëmarrja e barabartë në jetë sociale, arsimore dhe ekonomike.

Këto të dhëna nënvizojnë domosdoshmërinë që Bashkia Tropojë të:

- sigurojë infrastrukturë të aksesueshme në të gjitha hapësirat publike dhe institucionet,
- ofrojë mbështetje të specializuar shëndetësore, sociale dhe emocionale, veçanërisht për gratë,
- nxisë punësimin dhe pavarësinë ekonomike të grave me aftësi të kufizuara,
- garantojë mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhuna dhe përfshirjen e kësaj kategorie në të gjitha politikatat lokale.

Përfshirja aktive e grave me aftësi të kufizuara në hartimin dhe zbatimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore është thelbësore, në mënyrë që masat të jenë të ndjeshme, gjithëpërfshirëse dhe të orientuara drejt krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht gjinisë apo aftësisë.



BASHKIA TROPOJE


Numri familjeve qe trajtohen me Ndhimë Ekonomike sipas kategorive

Njesia Administrative	Nr Familjeve	Familje me gra kryefamiljare	Familje në përbërjen e tyre persona me PAK	Viktima te dhunës në familje	Familje që I përkasin komunitetit Rom	Femije me shërbim kujdestarie
1 Bajram Curri	165	38	37	1	13	1
2 Tropoje (e vjeter)	361	93	53	2	0	0
3 Fierzë	125	11	18	1	0	0
4 Bujan	285	38	28	0	0	0
5 Llugaj	157	35	16	3	0	0
6 Lekbibaj	96	16	12	1	0	0
7 Margegaj	154	28	21	0	0	1
8 Bytyç	126	23	14	0	0	0

Tabelat më sipër tregojn familjet që trajtohen me Ndhimë Ekonomike pranë Bashkisë Tropojë .Nga statistikat e hartuara nga Shërbimi Social i Bashkisë na rezultojnë që **1469** familje janë përfituese nga sistemi i ndihmës ekonomike.Kategoria e familjeve me Ndhimë Ekonomike ku kryefamiljare kemi gratë na rezultojnë **282** familje përfituese nga sistemi i ndihmës ekonomike.

Kemi **199** Familje përfitues të Ndhimës Ekonomike që në përbërjen e tyre kanë persona me aftësi të kufizuar Nga përfitimi i Ndhimës Ekonomike kemi **13** familje që i përkasin Komunitetit Rom si dhe na rezultojn përfituese edhe **8** viktima të dhunës në familje dhe **2** femijë me shërbim kujdestarie .

Edhe nga përfituesin e Ndhimës ekonomike del qartë që Femrat janë më në vëshirësi ekonomike pasi kemi **19 %** te familjeve me kryefamiljare gra ,një numër jo pak i konsiderushëm .





BASHKIA TROPOJE

Numri i bizneseve në territorin e Bashkise

Bashkia Tropoje	Total	Meshkuj	Femra
Numri I bizneseve	398	320	78

Biznese






Numri i Fermere që operojnë në Territorin e Bashkisë

Bashkia Tropoje	Total	Meshkuj	Femra
Numri i Fermere	121	63	58


Fermere



Në Bashkinë Tropojë kemi 398 biznese të regjistruara nga të cilat janë 320 subjekte në emer të meshkujve dhe 78 në emra të femrave .

Kemi 121 fermer që janë të regjistruar nga të cilët 63 janë meshkuj dhe 58 femra .

Diferenca është e qartë mes dy gjinive ku një ndër objektivat tonë është rritja e aksesit të grave dhe të reja, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre . Të promovojmë të drejtat e tyre ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë .



Mekanizmi i Referimit të Rasteve Te Dhunës në familje .


Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në familje vepron në nivel vendor konform Protokollit të Menaxhimit të Rasteve në bazë të Ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar dhe VKM 334/2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” .

Gjatë viteve 2023-2025 janë trajtuar rreth 21 raste të dhunës në familje, paraqitur në tabelën më poshtë.

Numri më i lartë i rasteve të dhunës rezulton në Njesinë Administrative Margegaj por analiza e rasteve tregon që janë të përfshirë të gjitha Njësitë.

Bazuar legjislacionit shqiptar rastet e pajisura me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje (UMM), dhe/ose Urdhër Mbrojtje (UM) përfitojnë NE prej 9900 lekësh. Në fakt të gjitha rastet me UMM/UM janë paguar ndër vite .

Sipas diskutimeve me profesionistë në Bashkinë Tropojë në zonat rurale të Bashkisë ka dhunë në familje, por ajo mbetet e paraportuar për shkak të mentalitetit, mungesës së informacionit, ndërgjegjësimit të ulët, nivelit të ulët ekonomike dhe varësisë ekonomike, mungesës së besimit tek institucionet.




BASHKIA TROPOJE

Rastet e dhunes ne familje në vitet 2023-2025

	Raste të dhunës me UM		
	2023	2024	2025
Bajram Curri	1	2	1
Tropoje (e vjeter)	1	2	0
Fierzë	0	0	1
Bujan	4	0	0
Llugaj	1	1	0
Lekbibaj	0	0	0
Margegaj	2	3	1
Bytyç	,0	2	0
Total			

Për vitin 2025 (deri në Korrik), evidentohen 3 raste te dhunës në familje, sipas të dhënave vetëm pas viti 2023 është bërë e mundur që rastet e dhunës me UM të përfitojnë pagesën sipas ligjit.

Në Bashkinë Tropojë mungojnë shërbime shoqërore në mbështetje të viktimave të dhunës. Mungesa e shërbimeve shoqërore për viktimat e dhunës dhe mungesa e burimeve financiare të Bashkisë për ngritjen e qendrës për menaxhimin e rasteve të dhunës, mungesa e organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime të specializuara në territor për rasteve e dhunës ka bërë që deri në Korrik 2025 rastet e dhunës në bashki të menaxhohen nga stafi i Bashkisë të ndihmuar me familjarë të viktimave të dhunës. Në disa raste bashkia është mbështetur nga OJF që operojnë në Tropojë. Ajo që vlen të përmendet është fakti se numri i rasteve të dhunës që trajtohen nga organizatat ka qenë relativisht shumë i ulët, kryesisht vetëm për rastet e rënda.




Megjithëse zhvillimet e mësipërme dhe angazhimet e pushtetit lokal në mbrojtje të viktimave të dhunës, megjithëse janë organizuar fushata të ndryshme informimi dhe ndërgjegjësimi për dhunën në familje, denoncimin e saj, dhe përfutimet e NE, sfiadat për Bashkinë Tropojë për mbështetjen e viktimave të dhunës janë:

1. Planifikimi i fondeve lokale për plotësimin e nevojave për menaxhimin e rasteve të dhunës;
2. Rritja e kapaciteteve të stafit të Bashkisë për evidentimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës;
3. Zgjerimi i MKR me kryepleqtë e fshatrave;
4. Vijimi i fushatave ndërgjegjëse për komunitetin, kryesisht në zonat rurale.


Shërbimet shoqërore të ofruara në vite në Bashkinë Tropojë kanë qenë sporadike, jo të konsoliduara dhe me kapacitete të limituara. Për shërbimet e mëparshme nuk janë realizuar vlerësime apo auditime. Në përfundim të projekteve, për shkak të mungesës së financimit, shërbimet janë mbyllur .

Bashkia Tropojë nuk ka të përcaktuar një koordinator/person përgjegjës të dedikuar për çështjet e Barazisë Gjinore (BGJ), por ka një person të dedikuar dhe i vendosur në strukturën e bashkisë për çështjet që lidhen me NJMF dhe Barazia Gjinore .Ka dhe një person të dedikuar për strehimin dhe Dhunën në familje .Bashkia Tropojë në vitin 2018 ka formalizuar Mekanizmin e Koordinuar të Referimit përmes nënshkrimit të marrëveshjes përkatëse për këtë qëllim ndërmjet 12 institucioneve anëtare, si një mundësi për të zhvilluar më tej konceptin e qasjes shumë-sektoriale të koordinuar .




Treguesit e sugjeruar gjinorë dhe socialë për Planin e Veprimit për Barazi Gjinore

Fusha	Treguesi	Njësia matëse	Disagregim	Përshkrimi
Përfaqësim dhe vendimmarrje në nivel vendor	Përqindja (%) e grave në pozita drejtuese në administratën vendore (zëvendës kryetare bashkie,drejtoare drejtorish,kryetare njësisish administrative)	Përqindje (%)	50 % janë gra 50 % burra janë	Në Bashkinë Tropojë kemi përfaqësimin e gruas ne 50% ne postet drejtuese . Diferenca është relativisht e madhe me gjininë tjetër .
	Përqindja (%) e grave në këshillin bashkiak	Përqindje (%)	28.57 % janë gra 71.43 % janë burra	Tregon përfaqësimin gjinor në organet e zgjedhura vendore
Punësim dhe ekonomi	Përqindja (%) e grave të punësuar në ndërmarrjet publike dhe shërbimet e bashkisë	Përqindje (%)	57 % janë gra 43 % burra	Reflekon barazinë gjinore në aksesin ndaj punësimit publik
	Përqindja (%) e grave që përfitojnë nga programet	Përqindje (%)	Gjinor; Social	Mat përfshirjen e grave në zhvillimin ekonomik vendor .




BASHKIA TROPOJE

	vendore të mbështetjes për vetëpunësim ose sipërmarrje		47.9% janë gra 52.1% janë burra	
Shërbime sociale dhe mbrojtje	Përqindja (%) e viktimave të dhunës me bazë gjinore që kanë aksesuar shërbime mbështetëse në nivel vendor	Përqindje (%)	90% gra 10 % burra	Mat aksesin në shërbime për viktimat e dhunës në familje ose dhunës me bazë gjinore %= $(\text{Numri i viktimave që kanë aksesuar shërbime mbështetëse në nivel vendor} / \text{Numri total i rasteve të raportuara për dhunë me bazë gjinore në territorin e bashkisë}) \times 100$
	Numri i rasteve të identifikuar dhe referuara nga bashkia për mbështetje të viktimave të dhunës në familje	Numër 20	Nga këta kemi 18 gra dhe dy burra	Reflekton kapacitetin e bashkisë për të identifikuar dhe menaxhuar raste të dhunës me bazë gjinore nga njësitë e mbrojtjes sociale, mekanizmat e referimit, shërbimet sociale;
Edukimi dhe ndërgjegjësimi	Numri i aktiviteteve ndërgjegjëse mbi barazinë gjinore dhe rolet gjinore në komunitet	Numër 7		Tregon angazhimin e bashkisë për edukimin komunitar mbi barazinë gjinore.




BASHKIRIA TROPOJË

	<p>Përqindja (%) e institucioneve publike vendore që zbatojnë praktika për barazi gjinore (kode sjelljeje, trajnime)</p>	<p>Përqindje (%)</p>	<p>Gjinor 70% janë gra .</p>	<p>Mat nivelin e integritit të perspektivës gjinore në planifikimin dhe buxhetimin vendor % = (Numri i projekteve/shpenzimeve që përfshijnë analizë dhe objektiva gjinore / Numri total i</p>
<p>Planifikim dhe buxhetim gjinor</p>	<p>Përqindja (%) e projekteve dhe shpenzimeve vendore që përfshijnë analizë dhe objektiva gjinore</p>	<p>Përqindje (%)</p>	<p>35% përfshin analizë gjinore</p>	<p>Mat numrin e aktiviteteve (fushata, trajnime, aktivitete publike, ditë sensibilizuese, forume, ekspozita, aktivitete edukative në shkolla, etj.) që organizohen nga bashkia, në bashkëpunim me OJF-të, shkollat, mediat apo komunitetin për promovimin e barazisë gjinore dhe promovimin e qasjeve të barabarta ndaj roleve gjinore.</p>
	<p>Tregon institucionalizimin e qasjes gjinore në sektorë të ndryshëm lokalë</p>			



BASHKIRIA TIRANË

					projekteve/shpenzimeve të planifikuara nga bashkia) × 100
	Përqindja (%) e projekteve të infrastrukturës sociale që janë zhvilluar me pjesëmarrjen e grave	Përqindje (%)	Gjinor; Territorial	65% janë gra	Mat përfshirjen e grave në planifikimin dhe vendimmarrjen për investime sociale
Pjesëmarrje qytetare	Përqindja (%) e grave që marrin pjesë në konsultime publike të organizuara nga bashkia	Përqindje (%)	Gjinor	42 % marrin pjesë në degjesa publike .	Tregon pjesëmarrjen aktive të grave në proceset e vendimmarrjes lokale % = (Numri i grave pjesëmarrëse në konsultime publike /Numri total i pjesëmarrësve në konsultime publike) × 100
	Përqindja (%) e iniciativave të Këshillit Bashkiak të realizuara që janë propozuar, mbështetur ose iniciuar nga Aleanca e Këshilltareve për çështje që lidhen me barazinë gjinore.	Përqindje (%)	Gjinor	70% e iniciativave është mbështetur .	Mat kontributin e drejtpërdrejtë të grave në qeverisjen vendore % = Numri i iniciativave të realizuara, të propozuara nga Aleanca/Numrine iniciativave të realizuara nga Këshilli bashkiak



Metodologjia


Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025–2027 është zhvilluar në bazë të një metodologjie të kombinuar, që ndërthur analizën e thelluar të kontekstit lokal me orientimin nga kuadri ligjor dhe dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, i bazuar në të dhëna statistikore gjinore, në vlerësime institucionale dhe në praktikat më të mira të planifikimit vendor të barazisë gjinore.

Hapi i parë metodologjik ka qenë shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe politik në të cilin do të mbështetet plani. Ky përfshinte, ndër të tjera, Ligjin nr. 9970 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, si dhe dokumente mbështetëse si Karta Evropiane për Barazinë Gjinore në Jetën Vendore dhe Agjenda 2030 e Kombeve të Bashkuara - Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ) 5, 10 dhe 16) Këto dokumente kanë orientuar konceptimin e objektivave, rolin e qeverisjes vendore dhe përgjegjësitë institucionale në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore.

Në vijim, u realizua një analizë e thelluar e situatës gjinore në territorin e bashkisë, e ndarë në dy shtylla: analiza territoriale dhe vlerësimi i kapaciteteve institucionale. Analiza territoriale u mbështet në të dhënat statistikore të përpunuara nga INSTAT dhe burime të tjera administrative, të cilat u ndanë sipas gjinisë dhe u trajtuan sipas tematikave kryesore: popullsia sipas grupmoshave, niveli arsimor, normat e analfabetizimit, statusi martesor, lidhja e grave me amësinë, dhe aksesin e fëmijëve në shërbimet e hershme të kujdesit (çerdhe dhe kopshte). U trajtuan edhe çështje që lidhen me personat me aftësi të kufizuara, si shpërndarja gjinore dhe lloji i kufizimit. U trajtuan Ndihma ekonomike, të verbër dhe para-tetraplegjikë, dhuna në familje, biznesët dhe fermerët .

Në vijim u shqyrtua praktika e mbledhjes së të dhënave me ndarje gjinore për çdo shërbim vendor. U evidentua se për disa shërbime ekziston mbledhje e rregullt e të dhënave, ndërsa për të tjera ka nevojë për përmirësim të kapaciteteve administrative dhe metodave të raportimit. Po ashtu, u vlerësua nëse bashkia ka zbatuar ndonjëherë buxhetim me perspektivë gjinore dhe në çfarë mase janë alokuar fonde për aktivitete që kontribuojnë në barazinë gjinore.

Kjo metodologji ka mundur jo vetëm një kuptim të qartë të sfidave gjinore në territorin e bashkisë, por edhe krijimin e një plani realist, të matshëm dhe të përshatshëm me burimet dhe kontekstin lokal të qeverisjes vendore.



Vizioni dhe objektivat strategjike

Në një periudhë trevjeçare, bashkia synon të ndërtojë një realitet të prekshëm të barazisë gjinore, ku çdo vajzë dhe çdo djalë, çdo grua dhe çdo burrë, kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga zhvillimi lokal. Përmes zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025–2027, do të konsolidohen strukturat institucionale, do të përmirësohet aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve publike, do të zgjerohet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në vendimmarrje, dhe do të ndërtohen komunitete më të sigurt, gjithëpërfshirëse dhe të ndryshme ndaj nevojave të ndryshme gjinore në çdo cep të territorit bashkiak. Vizioni i këtij plani është që barazia gjinore të mos mbetet një parim në letër, por të përkthehet në përfitime konkrete në jetën e përditshme të qytetarëve.

PLANI I VEPRIMIT


Qëllimi Strategjik: 1

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Ky qëllim synon ta bëjë barazinë gjinore një pjesë përbërëse të kulturës institucionale të bashkisë, duke e integruar në strukturat, praktikatat dhe komunikimin publik. Ai përfshin tre objektiva specifike:

Qëllimi strategjik 1:


Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.



BASHKIA TREPÇE

Objekti Specifik (O1.1) Të krijohet një sistem i qëndrueshëm, transparent dhe periodik raportimi publik mbi progresin dhe angazhimet e Bashkisë për barazinë gjinore, përmes përdorimit të të dhënave gjinore, platformave digjitale dhe përfshirjes qytetare.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.1.1 Publikimi i Planit të Veprimit në faqen e internetit të bashkisë dhe të KBRE-së.	2025	Njësia përgjegjëse për administrimin e faqes zyrtare ëeb të bashkisë; IT I/e bashkisë	Sekretariati i Këshillit Bashkiak, Komisioni i këshillit bashkiak për barazinë gjinore, aleanca e grave këshilltare		Plani i publikuar dhe qasja publike në faqen zyrtare
1.1.2 Hartimi i udhëzimeve dhe tabelave të treguesve për monitorim.	2025	Njësia e Planifikimit Strategjik dhe Njësia e performancës	Njësia përgjegjëse për hartimin e statistikave/performancës		Dokument i përfunduar dhe shpërndarë në drejtorinë përkatëse
1.1.3 Trajnim për punonjësit mbi mbledhjen e të dhënave me tregues gjinorë.	2025 - 2027	Njësia e Burimeve Njerëzore	INSTAT Donator	180,000	Numri i punonjësve të trajnuar dhe vlerësimi pas-trajnim
1.4.5 Përfshirja në rubrikën përkatëse të seksionit për konsultime publike për buxhetimin dhe nxitjen e pjesëmarrjen gjinore	2025	Njësia përgjegjëse për hartimin e Buxhetit Afatmesëm	Njësitë Administrative, Aleanca e Grave Këshilltare		Seksioni funksional dhe pjesëmarrje gjinore në konsultime




BASHKIA TROPOJË

1.4.6 Kalendar Lokal dhe organizim i aktiviteteve për Ditët Ndërkombëtare të të Drejtave të Grave dhe DHF	Viti 2025 (i përsëritshëm çdo vit)	Njësitë përgjegjëse për kulturën dhe shërbimet sociale	Shkolla, OJF lokale, Bashkia Tropojë	200,000	Numri i aktiviteteve të organizuara sipas kalendarit
1.4.7 "Buxheti i Barazisë": stimulim edukues në shkolla të mesme ku nxënësit mësojnë të planifikojnë buxhetin publik me lente gjinore.	2025-2027	Njësitë përgjegjëse për kulturën dhe shërbimet sociale	Shkolla, OJF lokale, Bashkia Tropojë		Numri i stimulimeve të organizuara në shkolla


Objektivi Specifik (O1.2) Të forcohen kapacitetet institucionale dhe strukturat organizative të Bashkisë për garantimin, koordinimin dhe integrimin e barazisë gjinore në të gjitha funksionet vendore.

Aktivite	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.2.1 Ngritja e funksionalizimi i Komisionit për BGJ në nivel Bashkie dhe përfshirja e Koordinatorit për BGJ në strukturën e Drejtorisë dhe Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	2025	Kryetari i Bashkisë	Drejtmësit e Drejtorive, Këshilli Bashkiak	80,000	Komisioni aktiv dhe mbledhje periodike të dokumentuara



BASHKËRIA TROPOJE


<p>1.2.2 Trajnim për anëtarët e Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie. (KBGJ) mbi buxhetimin gjinor.</p>	<p>2025</p>	<p>Zyra e Ndihtmes Ekonomike dhe e Çeshitjeve Sociale</p>	<p>Ekspertë të kontraktuar</p>	<p>100,000</p>	<p>Numri i trajnimeve dhe përfshirja e anëtarëve</p>
<p>1.2.3 Program trajnimi për zyrtarët bashkiakë mbi barazinë gjinore dhe anti-diskriminimin sipas një kalendarit vjetor të miratuar.</p>	<p>2025 - 2027</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore</p>	<p>Shkolla e Administratës Publike</p>	<p>300,000</p>	<p>Numri i trajnimeve të zhvilluara sipas kalendarit vjetor</p>
<p>1.2.4 Draftimi dhe miratimi një politike lokale kundër ngacimit seksual dhe diskriminimit (PSEA)</p>	<p>2025 - 2027</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore & Sektori i Nd.Ekonomike Cështjeve Sociale,</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Zyra e Cështjeve Sociale, Donatorë & OJF</p>	<p>300,000</p>	<p>Dokumenti i plotkave i miratuar</p>



BASHKIA TROPOJË


Objektivi Specifik (O2.1) Të garantohet akses i barabartë dhe territorialisht i balancuar në shërbime publike cilësore dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes zhvillimit të strukturave vendore, mbështetjes ekonomike dhe ndërgjegjësimit komunitar.

Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.1.1 Krijimi dhe funksionalizimi i strukturave të NJVRR (Njësitë Vendore të Referimit dhe Reagimit) për çdo njësi administrative	2025	Drejtoria ekonomike dhe Sektori i ndihmes ekonomike & Shërbimit Social	Njësitë Administrative, dhe Sektori i Shërbimit Social Policia, Shërbimi Shëndetësor	200,000	Numri i strukturave NJVRR të ngritura dhe funksionale në njësi administrative
2.1.2 Ndërgjegjësim i të rinjve mbi prindërimin e balancuar gjinor.	2025-2027	Drejtoria ekonomike dhe Sektori i ndihmes ekonomike & Shërbimit Social	ZVA dhe shkollat e mesme, Donatorë dhe OJF Sektori i ndihmes ekonomike & Shërbimit Social	200,000	Numri i fushatave të ndërgjegjësimit
2.1.3 Krijimi programi vjetor të granteve të vogla për nxitjen e	2025-2027	Drejtoria ekonomike dhe Sektori i	Bashkia Tropojë	1,000,000	Numri i granteve të dhëna; % e përfituesve nga zonat rurale




BASHKIA TROPOJË

nismave sociale dhe bizneseve të vogla të grave (me vëmendje për zonat rurale)	ndihmes ekonomike & Sherbimit Social			
2.1.4 Zhvillimi i një programi të dedikuar trajnimi për vajza dhe djem të rinj, me fokus në zhvillimin e aftësive për ofrimin e shërbimeve në sektorin e turizmit, si një mundësi për rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik të komunitetit.	Drejtoria ekonomike dhe Sektori i ndihmes ekonomike & Sherbimit Social Sociale	Bashkia Tropojë Zyra vendore AKPA Drejtoria rajonale formimit profesional	200,000	Numri i programeve të reja të trajnimeve
2.1.5 Krijimi dhe funksionalizimi i një njësie lëvizëse për ofrimin e shërbimeve të integruara shëndetësore dhe sociale në banesë, me fokus të veçantë tek grate e vetmuara (të veja dhe të moshuara) dhe personat me AK, me qëllim përmirësimin e aksesit në shërbime bazë dhe rritjen e përfshirjes sociale të	Drejtoria ekonomike dhe Sektori i ndihmes ekonomike & Sherbimit Social Njësitë përgjegjëse, shërbimet publike	Njësitë Administrative	100,000	Numri i grave dhe burrave përfitues




BAŠKIRIA TROPËJE

këtyre grupeve vulnerabël.					
2.1.6 Zhvillimi i moduleve të ndërgjegjësimit mbi barazinë gjinore në bashkëpunim me ZVA dhe shkollat fillore	2025-2027	Drejtoria Ekonomike, Zyra e ndihmes ekonomike e Cështjeve Sociale	ZVA, OJF edukative, mësues të përzgjedhur	1,200,000	Numri i moduleve të zhvilluara dhe numri i shkollave pjesëmarrëse
2.1.7 Ofrimi e këshillimit të karrierës për vajzat e djemtë dhe ndërgjegjësimit për rolet dhe profesionet gjinore.	2025-2027	Drejtoria Ekonomike, Zyra e ndihmes ekonomike e Cështjeve Sociale	ZVA, shkolla 9 vjecare dhe te mesme	900,000	Numri i sesioneve të këshillimit
2.1.8 Mbështetje për gratë në bujqësi përmes skemave të granteve dhe aksesit në kredi me kushte lehtësuese.	2025-2027	Drejtoria e ekonomike dhe Zyra e nd.ekonomike Cështjeve Sociale	Njësia e Buxhetit, Njësia e Bujqësisë, OJF		Numri i grave që kanë përfituar grante në bujqësi
2.1.9 “Harta e Bizneseve të Grave”: platformë online për promovimin dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse.	2025-2027	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	IT, OJF		Platforma elektronike online




BASHKIA TROPOJË

<p>2.1.10 Formim profesional për vajzat dhe gratë në profile të kërkuara nga tregu lokal i punës</p>	<p>2025-2027</p>	<p>Drejtoria Ekonomike, Zyra e ndihmes ekonomike e Cështjeve Sociale</p>	<p>AKPA Drejtoria rajonale formimit profesional</p>	<p>Numri i vajzave dhe grave që kanë zhvilluar kurse profesionale.</p>
<p>2.1.11 “Gratë që frymëzojnë qytetin tim”: Promovimi i figurave aktive dhe model të grave të komunitetit lokal</p>	<p>2025-2027</p>	<p>Drejtoria e Drejtoria Ekonomike, Zyra e ndihmes ekonomike e Cështjeve Sociale</p>	<p>Bashkia Tropojë</p>	<p>Numri i aktiviteteve promovuese të zhvilluara</p>
<p>2.1.12 Krijimi i memorialeve dhe organizimi i ekspozitave për figura historike femërore me ndikim në qytetin dhe historinë e Bashkisë</p>	<p>2025-2027</p>	<p>Drejtoria Ekonomike, Zyra e ndihmes ekonomike e Cështjeve Sociale</p>	<p>Bashkia Tropojë</p>	<p>Numri i memorialeve dhe ekspozitave të zhvilluara.</p>
<p>2.1.13 “Barazi në tokë”: program për të drejtat pronësore të grave në zonat rurale, me ndihmë ligjore dhe fushata ndërgjegjësimi.</p>	<p>2025-2027</p>	<p>Drejtoria Ekonomike, Zyra e ndihmes ekonomike e Cështjeve Sociale</p>	<p>Bashkia Tropojë</p>	<p>Numri i grave që kanë përfituar ndihmë ligjore dhe fushata ndërgjegjësimit.</p>




Objekti i Specifik (O2.2) Të forcohet reagimi institucional shumë-sektorial ndaj dhunës me bazë gjinore, përmes mekanizmave të koordinuar, qasjeve të ndjeshme gjinor dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë për viktimat në situata të zakonshme dhe emergjente.

Aktivitetet	Periudha	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.2.1 Hartimi dhe miratimi i një protokollit të ri të ndjeshëm gjinor për reagim në raste diskriminimi gjinor, dhe dhune mbi bazë gjinore.	2025	Njësia përgjegjëse për shërbimet	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; Qendra Shëndetësore, OJF, Ministria e Shëndetësisë	150,000	Dokument protokollit i miratuar dhe i shpërndarë në strukturat vendore
2.2.2 Fushatë ndërgjegjësimi për dhunën me bazë gjinore.	2025–2027	Drejtoria ekonomike dhe Sektori i ndihmes ekonomike & Sherbimit Social	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; OJF,		Numri i fushatave të ndërgjegjësimit




2.2.3 Krijimi i një sistemi gatishmërie për rastet emergjente 24/7	2025-2027	Drejtoria ekonomike dhe Sektori i ndihmes ekonomike & Sherbimit Social	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; OJF,	Krijimi i një sistemi gatishmërie për rastet emergjente 24/7
2.2.4 Trajnime për mësuesit, policinë dhe mjekët për identifikimin dhe referimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në nivel lokal	2025-2027	Drejtoria ekonomike dhe Sektori i ndihmes ekonomike & Sherbimit Social	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; OJF,	Numri i trajnimeve të zhvilluara. Numri i të trajnuarve.
2.2.5 Ndihmë integrale për viktimat e dhunës me bazë gjinore (psikolog, ndihmë ligjore, strehim emergjent)	2025-2027	Drejtoria ekonomike dhe Sektori i ndihmes ekonomike &	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; OJF,	Numri i trajnimeve të zhvilluara. Numri i të trajnuarve



Sherbimit Social

2.2.6 Forcimi i MKR dhe rritja e effciences.	2025-2027	Drejtoria ekonomike dhe Sektori i ndihmes ekonomike & Sherbimit Social	Drejtoria e Cëshjtjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; OJF,	Qendra Ligjore e Ndhmës Falas	200 000	Numri i rasteve të trajtuara dhe këshillimeve të ofruara.
2.2.7 Konsulencë psikologjike falas për çështjet e diskriminimit gjinor;	2025-2027	Drejtoria ekonomike dhe Sektori i ndihmes ekonomike & Sherbimit Social				



Monitorimi dhe raportimi

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025–2027 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, pjesëmarrëse dhe të bazuar në të dhëna.

6.1 Qasja dhe parimet e monitorimit

Monitorimi do të jetë:


- i strukturuar, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese;
- i bazuar në tregues të matshëm, të përcaktuar për çdo aktivitet;
- i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktorëve jo publikë, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen.

6.2 Aktorët përgjegjës

- Koordinatori për barazinë gjinore do të luajë rolin koordinues dhe teknik për grumbullimin dhe analizën e të dhënave.
- Komisioni për Barazinë Gjinore në Bashki (KBGJ) do të ndjekë progresin në nivel strategjik dhe do të raportojë në Këshillin Bashkiak.
- Drejtoritë dhe njësitë zbatuese përkatëse janë përgjegjëse për dërgimin periodik të informacionit mbi zbatimin e aktiviteteve.

6.3 Treguesit e progresit

Për secilin aktivitet në plan janë përcaktuar tregues të qartë si: numri i trajnimeve të realizuara, pjesëmarrja gjinore në aktivitete, numri i strukturave të ngritura, përfshirja e komunitetit në konsultime, etj. Treguesit janë ndarë sipas gjinisë dhe, aty ku është e mundur, sipas grupmoshës dhe zonës (urbane/rurale).



6.4 Formatet e raportimit

Raportimi do të realizohet:

- Çdo 6 muaj, përmes një formati të thjeshtuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës gjinore, që do të përdoret nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative.
- Çdo vit, përmes një raporti të përmbledhur vjetor mbi progresin e Planit, i cili do të publikohet në faqen e internetit të bashkisë dhe do t'u prezantohet këshilltarëve dhe komunitetit.
- Raporti vjetor do të përmbajë analiza të të dhënave, shembuj praktikë nga territori, si dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

6.5 Mbledhja e të dhënave, analiza dhe dixhitalizimi

Brenda vitit të parë të zbatimit, do të krijohet një regjistër dixhital për monitorimin dhe publikimin e statistikave gjinore dhe progresit të planit. Ky informacion do të jetë e hapur për publikun, duke mundësuar qasje transparente në të dhëna dhe nisma.

6. Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar

Në fund të vitit 2025 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme. Në vitin 2027, do të përgatitet raporti përfundimtar i zbatimit, që do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm.

Kostot e parashikuara në këtë dokument janë indikative dhe të përgjithshme. Përlogariftja e detajuar e kostove sipas aktivitetit, vitit të zbatimit dhe burimeve të financimit do të kryhet në një fazë të mëvonshme, në bashkëpunim me drejtoritë përkatese dhe në përputhje me mundësitë buxhetore të Bashkisë Tropojë dhe partnerëve të tjerë të përfshirë.